INTESA SANPAOLO BANK
Albania

## Kushtet e Punes per Biznesin e Vogel

| Produktet dhe Sherbimet | | | Komisionet dhe Kushtet | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | LEK | EURO | USD | GBP | CHF |
| **1. Llogari Rrjedhese** | | | | | | | |
| Hapje Llogarie | | | Falas | | | | |
| Mbyllje Llogarie | Jo perpara 3 muajsh nga celja | | Falas | | | | |
| | Perpara 3 muajsh nga celja | | € 30 | | | | |
| Komision mujor per mbajtje llogarie (Falas per muajin e celjes se llogarise) | | | 500 | 5 | 5 | 5 | 5 |
| Komision mujor per mbajtje llogarie per Fermere | | | 150 | 5 | 5 | 5 | 5 |
| Llogari Kursimi per OJF | | | Falas | | | | |
| Komisione mujor per mbajtje llogarie per OJF (kur jane ne te njejten monedhe me llog. ekzisuese) | | | 250 | 2.5 | 2.5 | 2.5 | 2.5 |
| Komision mujor per mbajtje llogarie noteresh "Per tjetersimin e pasurive te paluajtshme" | | | Falas | | | | |
| Balance minimale ne llogari rrjedhese | | | 3,000 | 30 | 30 | 30 | 30 |
| Aktiviteti i llogarise | | | Falas per muajin aktual<br>€1 /ne muaj per periudhat e meparshme | | | | |
| Aktiviteti i llogarise i derguar cdo dite elektronikisht | | | €10/muaj | | | | |
| **2. Veprime ne "Kesh"** | | | | | | | |
| Depozitime "Kesh" | | | Falas | | | | |
| Terheqje "Kesh" nga llogaria | deri ne Lek 300.000 ose ekv | | Falas | | | | |
| | mbi Lek 300.000 ose ekv | | Lek 150 | | | | |
| Pagesa ne "Kesh" ne favor te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve | | nga Kliente | Lek 250 | | | | |
| | | nga jo-Kliente | Lek 2,000 | | | | |
| Pagesa dogane ne "Kesh" | nga Kliente | | Lek 150 | | | | |
| | nga jo-Kliente | | Lek 1,000 | | | | |
| Pagesa ne "Kesh" ne favor te Llogarive te Thesarit dhe Kompanive Utilitare (Pagesa te Faturave mujore) | | nga Kliente | Lek 150 | | | | |
| | | nga jo-Kliente | Lek 200 | | | | |
| **3. Kembime Valutore** | | | | | | | |
| Kembime Valutore nga Llogaria | | | Falas | | | | |
| **4. Letra me vlere te qeverise shqiptare** | | | | | | | |
| Aplikim nepermjet ISBA (Bono Thesari dhe Obligacione) | | | 1.5 o/oo e shumes nominale, min LEK 1,000; max LEK 5,000 | | | | |
| Aplikim nepermjet Bankes se Shqiperise (Ekzekutimi I veprimeve cash i Bonove te Thesarit) | | | Lek 700 | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **5. Depozite me Afat** | | | | | | |
| Hapja / Rinovimi i Depozites | | Falas | | | | |
| Penalitet per thyerje te depozites | | Interesat e akumuluara | | | | |
| **6. Pagesa** | | | | | | |
| **Pagesa brenda bankes ISBA** | | | | | | |
| Pagesat midis llogarive te ISBA | degeve ne te njejtin qytet | Falas / brenda dites | | | | |
| | degeve ne qytete te ndryshme | Falas / + 1 Date valute * | | | | |
| Kryerja e Pagesave periodike nga llogaria sipas Instruksioneve | | € 1/ transaksion | | | | |
| Komision per perdorim fondesh perpara date valutes (llogaritur: amt*dite*X %/360) | | 17 % p.a | 13 % p.a | 13 % p.a | | |
| * per veprimet me Internet -Banking nuk aplikohet date valuta | | | | | | |
| **Pagesa te faturave Utilitare** | | | | | | |
| Pagesat me Marreveshje Debitimi Dierkt | | Falas | | | | |
| Pagesat e faturave te Energjise Elektrike, Albtelecomit **, Tel. Celulare, Uje, etj. | | Lek 50 * | | | | |
| ** per veprimet me internet banking nuk aplikohet komisioni i pageses;*<br>***nuk aplikohet komision (paguhet nga operatori)* | | | | | | |
| **Pagesat e Taksave dhe detyrimeve te tjera ne favor te Buxhetit te Shtetit** | | | | | | |
| | | | | | | |
| Pagesa nga llogaria ne favor te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve* | | Lek 150 | | | | |
| Pagesa nga llogaria ne favor te Llogarive te Thesarit | | Lek 50 | | | | |
| Pagese dogane nga llogaria | | Lek 50 | | | | |
| ** per veprimet me internet banking nuk aplikohet komisioni i pageses* | | | | | | |
| **Pagesa ne mberritje** | | | | | | |
| Pagesa ne mberritje nga banka te tjera | Date valute | + 2 dite pune | | | | |
| | Pagesa ne mberritje ne Lek | Falas | | | | |
| | Pagesa ne mberritje ne monedhe te huaj(*) | | 1.5 o/oo, min. € 7, max. € 70 | | | |
| Komision per perdorim fondesh perpara date valutes (llogaritur: amt*dite*X %/360) | | 17 % p.a | 13 % p.a | 13 % p.a | | |
| **Pagesa ne Nisje** | | | | | | |
| Pagesa ne nisje - Date valute | | + 2 dite pune | | | | |
| Pagesa ne nisje in Lek | Deri ne Lek 1,499,999 | Lek 500 | | | | |
| | Mbi Lek 1,500,000 | Lek 1,500 | | | | |
| Pagesa ne nisje ne monedhe te huaj | Urdheruar nga LLogaria | | 1.5 o/oo min. € 20 max. 250 € (plus SWIFT ) | | | |
| | Urdheruar ne "Kesh" | | 2.5 o/oo, min. € 20 max. 350 € (plus SWIFT ) | | | |
| Komisione SWIFT | | € 10 | | | | |
| Investigim mbi pagesat (ne nisje/mberritje) | | Lek 3,000 | € 25 | | | |
| Modifikim / Anullim Pagese | | Lek 3,000 | € 25 | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Komisione shtese per transfertat me opsionin e komisioneve "OUR"** | | | | | | |
| Pagesat me komision "OUR" (ne EURO) | Per shumat 0 - €10,000 | | € 11 | | | |
| | Per shumat €10,001 - €50.000 | | € 21 | | | |
| | Per shumat mbi €50.000 | | € 40 | | | |
| Pagesat me komision "OUR" (ne USD) | Per shumat 0 - $20,000 | | | $25 | | |
| | Per shumat mbi $20.000 | | | $50 | | |
| Pagesat me komision "OUR" ne GBP dhe CHF | | | | | £30 | 30 |
| Komisone per pagesat Urgjente /jo SPOT (llogaritur: shuma*ditet*X %/360) | | 7%, min €5 | 5%, min €5 | 4.5% min €5 | 7% min €5 | 7% min €5 |
| Nisje me e-mail te kopjes se njoftimit per kryerjen e pagesave (MT 103) | | € 5/muaj | | | | |

| | | |
|---|---|---|
| **7. Karta Plastike** | | |
| **American Express Karte Biznesi** | | |
| Pagesa e fatures mujore te Kartes American Express | | € 10 |
| **Karta MasterCard / Biznesi** | | |
| Leshimi i kartes | | Falas |
| Tarifa mujore e sherbimit per çdo karte primare | | € 5/karte |
| Tarifa mujore e sherbimit per çdo karte suplementare | | € 2.5/karte |
| Transaksione ne ATM- te e ISBA ne Shqiperi | | Falas |
| Transaksione ne ATM-te e bankave te tjera ne Shqiperi | | € 2 |
| Komision per veprime me POS ne Shqiperi | | Falas |
| Komision per veprime ne ATM jashte shtetit | | 2.5 % e shumes min € 2.5 |
| Komision per veprime jashte shtetit ne POS/Internet | | 1.5 % e shumes min € 2 |
| Bllokimi i kartes | | Falas |
| Zevendesimi i kartes / i Kodit sekret (PIN) | | Lek 1,000 |
| Zevendesimi i kartes se skaduar | | Falas |
| **8. Checks** | | |
| Bllok Çeqesh (25 çeqe) | | € 10 |
| Ndalim pagese te çekut | | € 10 per cek |
| Komision per kthim ceku te papaguar | | Falas |
| **Leshuar nga Banka / ISBA** | | |
| Cek Bankar (ne monedhe te huaj) | nga Kliente | 2 o/oo, min. €15, max. €200 |
| | nga jo-Kliente | 2.5 o/oo, min. €25, max €250 |
| Cek Bankar (ne Lek) | nga Kliente | 2 o/oo, min. €15, max. €200 |
| | nga jo-Kliente | 2.5 o/oo, min. €25, max €250 |
| **Pranuar nga banka (per Klering )** | | |
| Ceqe te ISBA | | Falas |
| Ne favor te nje llogarie te ISBA | | 2 o/oo, min €10, max. €100 |
| Ne favor te nje llogarie ne nje banke tjeter | | 2 o/oo, min €10, max. €100 |
| Çeqe per arketim | | 2 o/oo ,min € 20, max € 200, plus komision swift-i |
| **9. Leter Kredi** | | |
| Leter Kredi Importi | Njoftim paraprak | € 10 |
| | Çelje Leter Kredie | 1.5 o/oo, min. €50, per cdo tremujor ose fraksion (parapagim) |
| | Modifikim | € 50 |
| | Shqyrtim dokumentash | 1 o/oo,min € 30 |
| | Pagese | 4 o/oo,min € 50 |

| | | |
|---|---|---|
| Leter Kredi Importi | Anullim | 4 o/oo e shumes se mbetur plus komisionet e bankes korrespondente |
| | Trajtim/ percjellje e dokumentave | € 30 |
| | Dokumente te parregullta | € 50 |
| Leter Kredi Eksporti | Njoftim paraprak | € 10 |
| | Njoftim | 1 o/oo,min € 50 per cdo tremujor ose fraksion (parapagim) |
| | Konfirmim | 2.5 o/oo,min € 100 per cdo tremujor ose fraksion (parapagim) |
| | Shqyrtim Dokumentash | 1 o/oo,min € 50 |
| | Pagese e Vonuar | 2 o/oo,min € 50 |
| | Anullim | € 50 |
| | Modifikim njoftimi | € 50 |
| | Trajtim/Percjellje Dokumentave | € 30 |
| | Pagese | 4 o/oo,min € 50 |
| | Transferim i Leterkredise | € 100 |
| Komisione te tjera | Te tjera | sipas rastit |
| | Mesazh SWIFT-i | € 10 |

**10. Garanci Bankare**

| | | | |
|---|---|---|---|
| Leshim Garancie per Pjesemarrje ne Tender (Garanci Tenderi) | Standarte | Lek 1,000 | € 30 |
| | Jo Standarte | Lek 2,000 | € 50 |
| Leshimi i tipeve te tjera te Garancise Bankare | Leshuar ne Forme Standarte | €30 / tremujor apo fraksion | |
| | Leshuar ne Forme Jo Standarte | €50 / tremujor apo fraksion | |
| | Modifikim | € 30 | |
| | Kryerje Pagese Garancie | 4 o/oo,min € 30 | |
| | Lirim GB para dates se skadences | € 10 | |
| G/B te mberritura nga banka te tjera ne favor te klienteve te ISBA (pa angazhim te bankes) | Advising | € 50 | |
| | Amendment | € 10 | |
| | Payment of the guarantee | 2 o/oo,min € 20 | |
| Komisone te tjera | Te tjera | sipas rastit | |
| | Mesazh SWIFT-i | € 10 | |

**11. Dokumenta per Arketim**

| | | |
|---|---|---|
| Dokumenta te mberritura per arketim | | 1 o/oo,min € 50 per tremujor ose fraksion |
| Pagesa te kryera kundrejt dok per arketim | | 2 o/oo,min € 20,max € 200, plus swift |
| Dokumenta te nisura per arketim | | 1 o/oo,min € 50 per tremujor apo fraksion |
| Pagesa te mberritura kundrejt dok per arketim | | 2 o/oo,min € 30,max € 100 |
| Komisone te tjera | Te tjera bankare | sipas rastit |
| | Mesazh SWIFT-i | € 10 |

**12. Kredi**

| **Lloji i Financimit** | | **Overdraft** | **Kredi Afat-shkurter** | **Kredi Investim** | **Linje kredie L/K ose G/B** |
|---|---|---|---|---|---|
| Monedha | | Lek;EUR | Lek;EUR | Lek;EUR | Lek;EUR |
| Afati | | 12 muaj | 4 vjet | 4-15 vjet | 12 muaj |
| Norma e Interesit | | ( 1Y TRIBOR-Lek/1Y EURIBOR-Euro + Marzhi) | | | |
| | Kur mbulohet me "Kesh" ne llogari | 0.5% e linjes se kredies | | | Falas |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Komision Administrimi | Kur mbulohet me Depozite me afat apo BTH ose Kunder-garanci | 0.5% e linjes se kredise | |
| | Kur mbulohet me Kolaterale "Jo  Kesh" | 1% e linjes se kredise min € 100 | 1% e linjes se kredise |
| Komisioni i Linjes | Nese eshte e mbuluar me "Kesh" ne llogari | | Falas |
| | Nese eshte e mbuluar me Depozite me afat apo BTH ose Kunder-garanci | | 1 % p.a (per tremujor apo fraksion, parapagim) |
| | Nese eshte e mbuluar me Kolaterale "Jo-Kesh" | | 2.5 % p.a (per tremujor apo fraksion, parapagim) |
| Komision angazhimi (mbi shumat e paperdorura) | | 1% p.a | |
| Penalitete per mosshlyerje  te kredise sipas afateve | | IR+ 10 % p.a | |
| Komision per pagese te parakohshme te kredise | | 3%   p.a e shumes se mbetur | |
| Komision per ndryshim Kolaterali | | Lek 10.000 | |
| **13. Sherbimi i “Internet Banking”** | | | |
| Komision Regjistrimi | | Falas | |
| Komision mujor mirembajtje per Bisnesin e Vogel | | € 8 | |
| Komision mujor mirembajtje per OJQ | | € 5 | |
| Celsi i Sigurise | | € 5 | |
| **14. Sherbimi i “Mobile Banking” – Intesa Mobile** | | | |
| Komision mujor | | Falas | |
| Celesi i sigurise | | Falas | |
| **15. Te ndryshme** | | | |
| Shpenzime Postare | | Lek 1,000 brenda vendit /€ 50 jashte vendit | |
| Komision vjetor per kasetat e sigurise | Tipi 1 ( 40 x5 cm) | € 150 | |
| | Tipi 2 ( 40 x10 cm) | € 200 | |
| | Tipi 3 ( 40 x17 cm) | € 300 | |
| Hapje e detyruar e kasetes se Sigurise | | € 100 | |
| Depozite sigurie gjate nates | | Free | |
| Investigim per transaksione te kryera perpara 6  muajsh | | € 30- € 100 | |
| Mesazh SWIFT -i | | € 10 | |
| Leter Reference | | € 100 | |
| Vertetim per gjendje llogarie | | € 10 | |
| Vertetim qe nuk ka marredhenie me banken | | € 10 | |
| Vertetim i leshuar me kerkese te  Auditoreve mbi gjendjen e llogarise se Klientit | | € 50 | |
| Njoftim permes SMS | | ALL 100 / month | |

## LIGJI PER SIGURIMIN E DEPOZITAVE

Agjencia e Sigurimit të Depozitave (Agjencia) është person juridik publik, me seli në Tiranë, e cila ushtron funksionet e saj me qëllim përmbushjen e objektivave në zbatim të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave" i ndryshuar.

"INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA" SHA, në bazë të ligjit Nr. 8873, datë 29.03.2002 "Per Sigurimin e Depozitave" I ndryshuar në Ligjin Nr. 53/2014, datë 22.05.2014, është pajisur nga Agjencia me Certifikatën për Sigurimin e Depozitave Nr. 10 datë 11.05.2009.

Në bazë të kësaj Certifikate, Agjencia, sipas Nenit 33, paragrafi 1 pika a) të Ligjit Nr. 53/2014 datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave", siguron dhe kompenson depozitat e sigurueshme të cdo depozituesi në Banken INTESA SANPAOLO BANKA ALBANIA SHA në masen 100 per qind, por në cdo rast jo më shume se 2,500,000 (dy million e peseqind mije) Lek, pavaresisht numrit të depozitave apo llojit të monedhes se tyre, të depozituara në këtë Bankë.

## A – PERKUFIZIME

"Certifikata e sigurimit të depozitave", bazuar në Nenin 3, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave, është akti administrativ i lëshuar nga Agjencia, me anën e të cilit një person juridik bëhet anëtar i skemës së sigurimit të depozitave.

"Depozitues", bazuar në Nenin 3, paragrafi 17 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 për "Sigurimin e Depozitave" i ndryshuar, është cdo person fizik, tregtar dhe shoqëri tregtare, të cilët kanë të drejten e perfitimit të pageses së një depozite nga një subjekt anëtar i skemës së sigurimit të depozitave, përfshirë këtu titullarin me të drejta të plota të një depozite në bashkëpronësi dhe çdo përfitues të një depozite të palës së tretë.

"Depozitë e sigurueshme", bazuar në Nenin 3, paragrafi 14 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave" i ndryshuar, është vlera e agreguar e të gjitha depozitave të një depozituesi, përfshirë interesin e përllogaritur të tyre në ditën e vlerësimit ose të ndërhyrjes në një subjekt anëtar të skemës, përveç përjashtimeve të nenit 32 të këtij ligji.

"Depozitë e siguruar në bankë dhe degë të saj", bazuar në Nenin 3, paragrafi 15 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave" i ndryshuar, është pjesa e depozitës së sigurueshme e një depozituesi, i cili mbulohet me sigurim nga Agjencia.

"Depozitat e pasigurueshme", bazuar në Nenin 32 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave i ndryshuar, janë depozitat e mëposhtme te cilat përjashtohen nga sigurimi dhe kompensimi nga Agjencia:

1) pjesa e depozitës në bankë ose degën e bankës së huaj me vlerë mbi 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) Lek ose shuma e barazvlefshme me të (kundërvlerën), në monedhë të huaj;

2) depozitat e bankës, degës së bankës, degës së bankës së huaj dhe shoqërisë së kursim-kreditit në emër dhe për llogari të vet, si dhe çdo subjekt tjetër financiar i licencuar nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

3) depozitat e drejtorit, administratorit në bankë dhe familjarëve të tyre, sipas çertifikatës së gjendjes familjare;

4) depozitat e çdo personi që zotëron 5 për qind ose më shumë në kapitalin e subjektit anëtar ose të aksioneve me të drejtë vote në këtë subjekt;

5) depozitat e prejardhura nga veprimtari të lidhura me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, të cilat janë deklaruar të paligjshme me vendim gjykate të formës së prerë;

6) depozitat e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, vendase ose të huaja;

7) depozitat e subjekteve të sipërmarrjes ose investimeve kolektive, vendase ose të huaja;

8) depozitat e fondeve të pensionit ose sigurimit pensional, vendase ose të huaja;

9) tituj të emetuar nga subjekte financiare dhe çdolloj detyrimi tjetër që këto subjekte kanë bazuar mbi marrëveshjet e tyre të premtimit;

10) depozitat e njësive të pushtetit qendror ose vendor, si dhe çdo enti publik të Republikës së Shqipërisë ose të një vendi të huaj;

11) depozitat të paemërtuara dhe/ose titulli i të cilave nuk përcaktohet qartë;

12) depozitat e vendosura në subjektin anëtar të skemës së sigurimit të depozitave gjatë dhe pas ditës së ngjarjes së sigurimit në këtë subjekt;

13) depozitat e anëtarëve të organeve drejtuese të shoqërisë së kursim-kreditit, sipas përcaktimeve në ligjin për shoqëritë e kursim-kreditit, përveç asamblesë së përgjithshme;

14) depozitat e personave juridik, përveç atyre të përcaktuara në pikën 17, të nenit 3, të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave" i ndryshuar.

"Shoqëri tregtare", bazuar në Nenin 3, paragrafi 34 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave" i ndryshuar, ka kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe/ose çdo ligj ndryshues i tij.

"Skema e sigurimit të depozitave", bazuar në Nenin 3, paragrafi 23 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave" i ndryshuar, është marrëdhënia juridike dhe veprimtaria për sigurimin dhe kompensimin e depozitave, që krijohet ndërmjet subjekteve anëtare të skemës dhe institucioneve publike në përfitim të depozituesve.

"Tregtar", bazuar në Nenin 3, paragrafi 33 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave" i ndryshuar, ka kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe/ose çdo ligj ndryshues i tij.

## B – SIGURIMI I DEPOZITAVE

1. Agjencia siguron depozitat e *individeve, tregtarëve dhe shoqërive tregtare* në bankat anëtare në skemë, bazuar në:

a) kontratën e depozitës;
b) dokumentet kontabël;
c) të dhënat e regjistrit elektronik.

2. Sigurimi i depozitës përfundon kur:
a) depozita klasifikohet si depozitë e pasiguruar,
b) depozita kompensohet nga Agjencia si pasojë e likuidimit të detyruar të bankës.

3. Në rastin e likuidimit vullnetar të bankës, depozitat mbeten të siguruara deri në përfundimin e këtij procesi.

4. Në rastet e riorganizimit juridik, depozitat e siguruara të bankave pjesëmarrëse mbeten të siguruara për çdonjërën prej tyre tre muaj pas datës në të cilën Agjencia njoftohet me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për përfundimin e procesit të transformimit.

5. Bankat zbatojnë nenin 26 të Ligjit *nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar* nëpërmjet krijimit, mirëmbajtjes dhe funksionimit të sistemeve elektronike për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave për vlerësimin e shumës së depozitave të siguruara në çdo kohë, sipas aneksit 11 "Vlerësimi i shumës së depozitave të siguruara" të saj.

6. Shuma e depozitave të siguruara është vlera aritmetike që shërben si bazë për përllogaritjen e primit dhe që rezulton nga zbatimi i hapave të mëposhtëm:

a) mbajtja e saktë e të dhënave personale të depozituesit dhe për depozitat e këtij depozituesi;
b) mbajtja e një numri të vetëm (kodit personal në sistem) të depozituesit, me qëllim që ai të identifikohet në mënyrë të saktë dhe pa përsëritje;
c) zbatimin e përjashtimeve nga skema e sigurimit të depozitave;
d) përllogaritjen e interesit përkatës të çdo depozite të depozituesit;
e) konvertimin e depozitave në valutë, në lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës;
f) zbatimin e kushteve kontraktore që zbatohen ndaj çdo depozite (sipas rasteve të përcaktuara në aneksin 11);
g) mbledhjen e të gjitha depozitave të depozituesit si një llogari depozitë e vetme.
h) krahasimi i vlerës së depozitës të vetme me 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

## C – KOMPESIMI I DEPOZITAVE

Procedurat e kompensimit, sipas nenit 39, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave" I ndryshuar, fillojnë menjëherë në momentin kur Agjencia njoftohet me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për vendosjen e subjektit anëtar të skemës së sigurimit të depozitave në likuidim të detyruar. Kompensimi përfundon jo më vonë se tre muaj nga data e fillimit të tij. Agjencia, sipas nenit 33, paragrafi 1 pika a) të Ligjit Nr.53/2014 datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave" i ndryshuar, siguron dhe kompenson depozitat e sigurueshme të çdo depozituesi në bankë ose në degën e bankës së huaj në masën 100 përqind, por në çdo rast jo më shumë se 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) Lek, pavarësisht numrit të depozitave apo llojit të monedhës të tyre, të depozituara në këtë bankë.

## D – TERMAT DHE KUSHTET PER PAGESEN E KOMPESIMIT

Niveli maksimal i kompensimit për çdo depozitues, sipas nenit 38, paragrafi 2 të ligjit Nr.53/2014 datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave" i ndryshuar, përllogaritet sipas përcaktimeve të nenit 33 të këtij Ligji, duke zbritur shumën e detyrimeve të papaguara në kohë të depozituesit ndaj subjektit anëtar, që rezulton në vonesë shlyerjeje në ditën e ndërhyrjes nga Autoriteti Mbikëqyrës. Agjencia, bazuar ne nenin 38, paragrafi 12 të Ligjit Nr. 53/2014 datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave", ka të drejtë të refuzojë kompensimin ose të kërkojë kthimin e kompensimit për depozitat e siguruara, kur e drejta për kompensim bazohet në të dhëna të pavërteta dhe mashtruese dhe kur vëren se nuk ka interes të sigurueshëm. Interes i sigurueshëm është interesi i ligjshëm dhe nevoja objektive e depozituesit për t'u mbrojtur nga humbja financiare e depozitave në një ngjarje sigurimi.

Agjencia, sipas nenit 39, paragrafi 4 të Ligjit Nr.53/2014 datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave", mund të kompensojë depozitën e siguruar nëpërmjet njërës prej këtyre mënyrave:

1) pagesës së shumës në Lek personit në ambientet e subjektit të vendosur në likuidim në bashkëpunim me likuidatorin;
2) pagesës së shumës në Lek personit në ambientet e një banke anëtare të skemës (banka agjente);
3) transfertës së shuës që përfitohet nga depozituesi në një bankë anëtare të skemës së sigurimit të depozitave;
4) pagesës me çek;
5) mënyra të tjera pagese të miratuara me akt nënligjor të Autoritetit Mbikëqyrës.

Shënim: Ky informacion jepet në zbatim te detyrimi për informimin e publikut nga subjektet anëtare të skemës ne baze të nenit 27 të Ligjit Nr. 53/2014 datë 22.05.2014 "Për Sigurimin e Depozitave".